



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.380 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE PËR INFORMIM, KOMUNIKIM DHE PJESMARRJE
QYTETARE 2016-2018

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për strategjinë komunale për informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare 2016-2018.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore. Strategjia e komunikimit është një përpjekje e re e komunës së Hanit të Elezit për të përmirësuar cilësinë e punës për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve si një institucion transparente, efektive dhe të përgjegjshme.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1168 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E MARRVESHJES SË BASHKPUNIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT NË MES TË CARITAS KOSOVA DHE KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për marrëveshjen e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të Caritas Kosova dhe komunës së Hanit të Elezit.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta bëjnë ekzekutimin e marrëveshjes.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1275 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12,40, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 05/L-071 për vitin 2016 neni 7, paragrafi 1.2, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendii i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 merr:

VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE TË VITIT 2014 DHE 2015 NË VITIN VIJUES 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2014 dhe 2015 në vitin vijues 2016.

II

Të hyrat e bartura nga viti 2014 në vitin 2015 kanë qenë në shumën prej 44,242.55 € dhe prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 44,134.14 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 108.41 €.

III

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2015 kanë qenë në shumë prej 223,521.25 €, prej tyre janë të shpenzuara 94,536.00 €, kurse për bartje janë edhe 128,985.25 €.

Pra, të hyrat vetanake të vitit 2014 dhe 2015 në total janë në shumën prej **129,093.66 €**, të cilat i bartim për vitin 2016.

IV

Këto mjete i shpërndajmë nëpër këto programe dhe nën-programe buxhetore dhe kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: shpenzime komunale në shumë prej 4,280.66 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 5,000.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 119,813.00 €.

V

Në kategorinë ekonomike **shpenzime komunale** në shumë prej **4,280.66 €** mjetet i bartim në programin Administrata dhe personeli (163) nën-programi (16335).

VI

Në kategorinë ekonomike **subvencione dhe transfere** në shumë prej **5,000.00 €** mjetet i bartim në programin Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16035).

VII

Në kategorinë ekonomike **shpenzime kapitale** shuma prej **119,813.00 €** në programet:

Në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) në projektet:
“Ndërtimi dhe rregullimi i procës në Lagjen e re” kodi (41624) në shumë prej 94,021.00 €;
“Mjete të lira për bashkëinvestime” kodi (41641) në shumë prej 24,000.00 €.

Në Programin Arsim dhe shkencë (920) nën-programi (92175) në projektin:

“Aneksi i shkollës fillore Ilaz Thaçi në Han të Elezit-faza e dytë” kodi (44180) në shumë prej 1,792.00 €.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit, ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IX

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2016





01/Nr.1274 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN -2015

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve të mjeteve buxhetore për vitin 2015

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin - 2015 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit është 2,051,844.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 2,204,662.56 € (duke përfshirë bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 44,242.55 €, mjete shtesë me rishikim të buxhetit në shumë prej 100,000.00 € nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në fund për mbulesë të kategorisë paga dhe mëditje në shumë prej 8,576.01 €). Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe mëditje 1,368,292.81 €, mallra dhe shërbime 267,500.00 €, shpenzime komunale 48,138.65 €, subvencione dhe transfere 50,082.10 € dhe shpenzime kapitale 470,649.00 €. Pjesën më të madhe të këtij buxheti e kanë pagat dhe mëditjet me 62.06%, shpenzime kapitale me 21.35%, mallrat dhe shërbimet me 12.13%, subvencionet dhe transferet me 2.18% dhe shpenzimet komunale me 2.27%. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i realizimit të përgjithshëm për këtë periudhë janar-dhjetor 2015 është në shumë prej 2,040,413.41 € apo 92.55 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,366,431.86 € (99.86%), në mallra dhe shërbime 264,565.53 € (98.90%), në shpenzime komunale 48,060.96 € (99.84%), në subvencione dhe transfere 47,639.60 € (95.12%) dhe në shpenzime kapitale 313,715.46 € (66.66%).

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 25.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1308/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d) , Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c). Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.02.2016 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2015

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2015.

II

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

III

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës-Hani Elezit
Municipality of Hani Elezit

01 .Nr./1698 2016
Data: 25.02.2016

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Procedurës Administrative nr. 02/L-28, neni 107, vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, nr.2801-2/10, i datës 15.07.2015 mbi transferin e pëlqimit mjedisor, kërkesës së palës me Nr.11/1698/2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 25.02.2016 merr këtë:

VENDIM

PËR TRANSFERIN E PËLQIMIT PËR SHFYTËZIM DHE EKSPLOATIMIN E GURIT GËLQEROR

I

Miratohet kërkesa e **z.Haki Kalisi** pronar „ **Preni** “ Sh.p.k me numër 11/Nr.1698 e datës 15.02.2016 për Transferin e pëlqimit për shfrytëzimin dhe eksploatimin e gurit gëlqeror në pjesën e ngastrës Nr.327/0, sipas Çertifikatës së pronës 06-714-1551/2016 dhe pjesës së ngastrës Nr.941/0 sipas Çertifikatës së pronës 06-714-1557/2016 e cila është pronë shoqërore e Ekonomisë pyjore në vendin e quajtur „Vorba” në zonën e kadastrave të fshatit Seçishtë, Komuna Hani i Elezit.

II

Duke ju referuar nenit -I- të këtij vendimi transferi i pëlqimit lëshohet duke pasur parasysh dokumentacionin e ofruar nga pala.

III

Pëlqimi lëshohet për marrjen e lejes për eksploatim të gurit, në Komisionin e pavarur për miniera dhe minerale, ndërsa për qëllime tjera nuk mund të përdoret.

IV

Ky pëlqim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.

IV

Me këtë pëlqim njoftohen: Pala, Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, MAPL-ja dhe Shërbimi i Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava